

16-02-2018



C.nr.709/16

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri me sekretaren juridike Lendita Pajaziti në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] të cilën e përfaqëson me autorizim av [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] pronar i Fabrikës së Miellit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj në çështjen juridike pasurim pa bazë, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më dt.06.02.2018, në prezencën e përfaqësuesit të paditësit, dhe në mungesë të paditurit, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesë padia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] si e bazuar

**II. DETYROHET** i paditura [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, që paditësit t'ia paguaj shumë prej 714,40€ (shtatëqind e katërmëdhjetë euro e katërmëdhjetë cent), në emër të pasurimit të pa bazë si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 464€, të gjitha brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

I autorizuari i paditësit në fjalën e tij ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke shtuar se nga administrimi i provave është vërtetua baza juridike e kërkesë padisë, kurse nga nxjerrja e provës përmes ekspertizë nga lëmia financiare është vërtetua lartësia e dëmit.

Andaj, ka kërkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesë padia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguaj borxhin në shumë prej 714.40€, si dëm që i është shkaktuar me rastin e mos pranimit të sasisë së miellit dhe kruneve që ka pasur ti merr nga i padituri si pronar i fabrikës së miellit [REDACTED] kur i ka dorëzuar sasinë e grurit.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesë padia e paditësit si e bazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës, të precizuara.

I padituri në seancën e datës 06.02.2018, ka munguar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flet kthesa e Gjykatës ku ftesën s'bashku ekspertizën financiare, e ka pranuar me datë 24.01.2018, shtyrjen nuk e ka kërkuar dhe mungesën

nuk e ka arsyetuar, andaj Gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

I padituri në seancën e dt.20.12.2017, ka deklaruar se e ka kundërshtuar padinë e paditësit duke theksuar se si pronar i fabrikës së Mfellit [REDAKTUAR] ka qenë i detyruar të mbaj shënime e të cilat shënime ka theksuar se nuk përputhen me shënimet e paditësit, duke premtuar se do ti sjell në seancën e radhës.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: U lexua padia e paditësit C.nr.709/16 dt.06.09.2016, autorizimi i paditësit dhenë av. [REDAKTUAR], aktvendimi procedural i nxjerr në seancën e dt.22.11.2017, me të cilën padia e paditësit është konsideruar e tërhequr, propozimi i paditësit dt.23.11.2017, ku ka kërkuar aprovimin e propozimit për kthim në gjendje të më parme, aktvendimi C.nr. 709/16 dt.24.11.2017, shikimi i kartelës –librezës për dorëzimin e grurit dhe pranimin e miellit dhe krunëve me nr. 20/113 dt.19.07.2013 dhe librezat tjetër e dt.20.07.2014 ( fotokopja mbetet në shkresat e lëndës, origjinali i kthehet palës), ekspertiza e ekspertit financiar [REDAKTUAR]

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të tyre një nga një dhe të gjitha sbashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e bazuar.

Gjykata nga provat e administruara dhe deklaratat e palëve ndërgjyqjësë gjeti se nuk ishte kontestuese se paditësi tek i padituri në kohën e korrijeve ka dërguar një sasi të grurit në fabrikën e miellit [REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR] pronar i së cilës është i padituri, por kontestuese ishte sasia e saj

Gjykata me rastin e vlerësimin të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat e administruara dhe atë kartela-libreza ku shihet se paditësi e ka dorëzuar sasinë e grurit tek i padituri dhe i padituri ka pasur për detyrim në kundërvlerë ka pasur që tja jep paditësit një sasi tjetër të miellit dhe kruneve të cilën pjesërisht paditësi e ka tërhequr nga i padituri siç shihet nga kartela-libreza me të cilën vërtetohet pranim-dorëzimi, me të cilin veprim janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në mes palëve konform nenit 130 të LMD-së.

Se i padituri e ka pasur për detyrim tja komepnztoj në emër të mallit të pranuar sasinë e miellit dhe krunëve kjo vërtetohet me anë të kartelave ku siç shihet se sipas kartelës-librezës për pranimin e mallit me nr.20/113 me dt.19.07.2013 paditësi e ka dorëzuar sasinë prej 2.210kg grurë dhe ka pasur që ti tërheq 1.150kg miell dhe 663kg krune nga e cila sasi i ka tërhequr me dt.06.08.2013 50 kg miell, 19.09.2013 50kg miell, 24.09.2014 45kg miell, 14.06.(viti i palexuar) 75kg miell, 09.12.2013 25kg miell,



18.11.2014 50kg miell dt.22.12.2014 50kg miell, 28.04.2014 50kg miell, 02.06.2014 50 kg miell, 22.07.2014 50kg miell 13.04.2015 25kg miell kurse me dt.29.05.2016 20kg krune, që rezulton se nga sasia e përgjithshme prej 1.150kg, që ka pasur paditësi ta tërheq nga i padituri e ka tërhequr vetëm sasinë prej 550kg miell kurse pjesën tjetër nuk e ka tërhequr, kurse sasinë që ka pasur ta tërheq nga sasia e përgjithshme prej 663kg krune e ka tërhequr vetëm sasinë prej 20kg kurse ka mbetur pa e tërhequr edhe sasinë prej 643kg krune.

Përveç kësaj paditësi e ka dorëzuar edhe me dt.20.07.2014 edhe sasinë e grurit prej 3.270kg, nga e cila ka pasur për detyrim i padituri t'ia jep 1.700kg miell dhe 981kg krune e prej të cilës nuk e ka tërhequr asnjë kg as miell as krune e që nga kjo rezulton se i padituri edhe pse ka pasur për detyrim që paditësi t'ia kthej nga sasia e përgjithshme të mbetur 2.300 kg miell dhe 1624 kg krune, nuk ia ka kthyer fare.

Meqenëse me anë të librezave-kartelave të lart cekura është vërtetuar se palët ndëgjygjëse janë pajtuar që paditësi sasinë e grurit të dorëzuar tek i padituri ti kompenzohet me sasinë e miellit dhe kruneve i padituri nuk e ka përmbushur një marrëveshje të tillë gjykata konsideron se i padituri është pasuruar pa bazë në raport me paditësin, gjykata sa i përket kësaj ka aprovuar kërkesën e precizuar duke e detyruar të paditurin t'ia paguaj paditësit shumën prej 714.40€, lidhur me këtë ka vendosur sipas bindjes së saj të lirë duke u bazuar në nenin 322 lidhur me nenin 253.2 të LPK-së duke e ndryshuar bazën juridike dhe nenin 194 të LMD-së, kurse në anën tjetër ku i padituri nuk e ka provuar me asnjë provë, se nuk ka detyrim sasinë e miellit dhe kruneve duke u bazuar në kërkesën e paditësit por më pak pasi që siç e ka marr për obligim që gjykatës ti sjell prova në seancën e dt.20.12.2017, që do ti sjell shënimet e tij me të cilat do të krahasoheshin me ato të paditësit, andaj gjykata ua ka falur besimin provave të paraqitura nga paditësi dhe mbi bazën e të cilave është përpiluar edhe ekspertiza e eksperti financiar ku i padituri është pasuruar pa bazë, në lartësinë e precizuar si në pikën II të dispozitivit.

Gjykata me rastin e vendosjes së lartësisë së kërkesë padisë është bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar të përpiluar nga eksperti [REDAKTUAR] i cili e ka caktuar shumën e dëmin prej 714.40 €, që i është shkaktuar paditësit me veprimet e të paditurit të aprovuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes gjithnjë ka pasur parasysh edhe interesat e të paditurit në këtë çështje kontestimore se mos po ju cenohen të drejtat dhe interesat e tij, por duke marr të gjitha provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës ka konstatuar se nuk i është cenuar ndonjë e drejtë ku dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri obligohet që paditësit tia paguaj shumën prej 464 € dhe atë për përpilim të padisë 104€, për dy seanca nga 135€, gjithsej 270€, për ekspertizë financiare 50€, për taksë gjyqësore për padi 20€ dhe për përpilim të aktgjykimit 20€, e cila është llogaritur në bazë të shumës së aprovuar të kërkesëpadisë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**C.nr.709/16, dt.06.02.2018.**

Gjyqtari  
Alban Beqiri



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
DHE ËSHTË I PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC



Më 08.03.2018

